

Nr _____ Prot _____

dt. _____.2018

RELACION TEKNIK

**"Ndërtim rrjet shpërndarës ujësjellësi në bllokun që kufizohet nga rruget:
"Demir Nazeri-Princ Vidi-Gjok Doci"**

1. QËLLIMI

Ky projekt zbatimi konsiston në ndërtimin e rrjetit të ri të ujesjellesit në bllokun që kufizohet nga rruget "Demir Nazeri-Princ Vidi-Gjok Doci".

2. VENDNDODHJA E PROJEKTIT

Ky projekt është i pozicionuar në pjesën perëndimore të qytetit të Tiranës dhe i përket Njësisë Administrative Nr.11i cili kufizohet nga rrugët Demir Nazeri, Princ Vidi, Gjok Doci si dhe nga Bashkia Kamez.




Fig.1.1 Vendodhja e projektit

3. GJENDJA E INFRASTRUKTURES EKZISTUESE

Aktualisht pjesa e rrugicave që kufizohet nga rrugët Demir Nazeri, Princ Vidi, Gjok Doci nuk furnizohet me ujë të pijshëm ose furnizohet në mënyrë jo të ligjshme.

Për këtë arsye u ndërmorë realizimi i një projektiper ndërtimin e një rrjeti të ri ujësjellesi në këtë zonë në mënyrë eliminimit të mundësive të furnizimit me ujë të pijshëm si dhe shmangien e lidhjeve të paligjshme.

4. BURIMET E INFORMACIONIT

Pjesa më e madhe e informacionit është marrë nga investigimet në terren të situatës ekzistuese dhe nga arshiva teknike e shoqërisë.

- Azhurnimi i rrjetit ekzistues të ujësjellesit dhe të kanalizimeve është marrë nga arkiva teknike e U.K.T. si dhe nga zhornimet në terren të situatës faktike.
- Kuotat e relievit dhe pusetave ekzistuese nga matjet topografike në terren
- Imazhet satelitore (nga harta virtuale globale Google earth)

5. RIKONSTRUKSION I RRJETIT TË RI TË UJËSJELLËSIT

Llogaritja hidraulike për rrjetin e ri

Llogaritjet hidraulike me qëllim dimensionim të rrjetit shpërndarës të ujësjellesit janë realizuar duke u nisur nga të dhënat e detyrës së projektimit dhe sipas normave të furnizimit me ujë.

- Nr. Banorëve = 320
- Norma e furnizimit me ujë **$n = 150 \text{ l / (banorë} \cdot \text{ditë)}$**
- Jetëgjatësia e veprës $t = 25$ vjet
- Shtesa natyrore e popullsisë $r = 2\%$
- Oret e furnizimit me ujë = 2 ore

Popullsia pas një periudhe $t = 25$ vjet do të llogaritet :

$$N_2 = N_1 \cdot (1 + r)^t = \text{banorë}$$

$$N_2 = 320 \cdot (1 + 0.02)^{25} = 525 \text{ banorë}$$

Vazhdojmë llogaritjet e $Q_{\max}^{\text{ditore}}$ per perdoruesit :

$$Q_{\max}^{\text{ditore}} = \frac{N_2 \cdot n}{1000} = \frac{525 \cdot 150}{1000} = 78.7 \text{ m}^3/\text{ditë}$$

Llogarisim prurjen mesatare orare $Q_{\text{mes}}^{\text{orare}}$

$$Q_{\text{mes}}^{\text{orare}} = \frac{Q_{\max}^{\text{dit}}}{2} = \frac{78.7}{2} = 39.3 \text{ m}^3/\text{orë}$$

Prurja maksimale orare :

$$Q_{\max}^{\text{orare}} = Q_{\text{mes}}^{\text{orare}} \cdot K = 39.3 \cdot 2 = 78.7 \text{ m}^3/\text{orë}$$

Prurja llogaritese totale per gjithë zonen me qellim dimensionimin e rrjetit eshte:

$$q_{\max}^{\text{sek}} = \frac{Q_{\max}^{\text{orare}}}{3.6} = \frac{78.7 \cdot 1000}{2 \cdot 3600} = 10.9 \text{ l/sek}$$

Prurja per dimensionimin e rrjetit per rrugicat ne veçanti :



Home | Materiali | Attrezzature | Impianti | Tabelle | **Fontane** | Calcoli | Disegni | Utilità | Contatti | Ricerca

Normative | Links | Video | Aggiornamenti | Acquisti | **Novità** | Segnalati

OPPO
www.oppo.it

0516

Calcolo
Portata - Sezione - Velocità

Dati di calcolo

D mm = Diametro interno della condotta


Q l/s = Portata della condotta

V m/s = Velocità del flusso

$Q = 0.785 \cdot D^2 \cdot V$

Lidhja e objekteve 1-3kt do te realizohet me tubacion PE Dj-25, per objektet 4kt lidhja do te behet me tubacion Dj-32mm PE, per objektet 5kt lidhja do te behet me tubacion Dj-40mm me perjashtim te disa rasteve ne varesi te lidhjes ekzistuese. Materialet e perdorura do te jene sipas standarteve te cilesise per ujin e pijshem.

PARAQITJA SKEMATIKE E PIKES
SE LIDHJES PER OBJEKTET



Lidhjet e objekteve do te sistemohen ne kaseta metalike te galvanizuara, ku tubacioni i furnizimit do te perfundoje me saraçineske. Te gjitha pusetat e manovrimit do te ndertohen sipas specifikimeve te projektit.

Projektues

Ing . Amarilda NANO

Pergj. Sektorit Projektimit

Ing.Albana MILO

